



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr859/3 Prot.

Tiranë, më 28/06/ 2021

V E N D I M

Nr. 112, Datë 28 /06/ 2021

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr.107 regj, datë 08.06.2021, paraqitur nga ankuesi H.C, kundër Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesi parashtron se, ka qenë punonjës në Ministrinë e Mjedisit dhe në vitin 2013 është pushuar padrejtësisht nga puna, duke u zëvendësuar me një person pa edukimin dhe kualifikimin që kërkonte vendi i punës. Ankuesi shpjegon se, ka ndjekur rrugën institucionale gjyqësore për të fituar të drejtën e tij dhe të gjitha nivelet e gjykatave janë shprehur me vendimet përkatëse, dhe konkretisht: vendimi nr.1672, datë 15.04.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, vendimi nr.1092, datë 15.05.2015, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë si dhe vendimi nr.00-2021-517, i Gjykatës së Lartë.

Ankuesi shprehet se të gjitha vendimet e mësipërme kanë shpallur pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nr.8120, datë 12.11.2013, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit. Këto vendime gjyqësore, i kanë njohur ankuesit të drejtën për t’u rikthyer në vendin e punës dhe të drejtën e marrjes së pagës deri në rikthimin e tij në vendin e punës.

Nga viti 2016 dhe deri më sot, ankuesi shprehet se ministria nuk i ka zbatuar këto vendime gjyqësore të formës së prerë, megjithëse zyra përmbartimore private, ka kryer të gjitha procedurat.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Ankuesi pretendon se, largimi i tij nga puna ka qenë thellësisht politik, pasi ai është nga një familje e dënuar dhe persekutuar për motive politike nga regjimi diktatorial monist, kjo e dokumentuar pasi xhaxhai i tij me vendimin nr.419, datë 23.10.1946 të Gjykatës Ushtarake të Elbasanit, është dënuar me 30 vjet burgim politik, si armik i popullit dhe sabotator i pushtetit popullor, duke i'u konfiskuar pasuritë. Ankuesi shprehet se, kalvari i vuajtjeve të familjes ka qenë tragjike deri në vitin 1991, dhe ka rifilluar që nga viti 2013 e në vazhdim.

Ankuesi shprehet se, ministria diskuton vendimet gjyqësore të formës së prerë, duke e zvarritur për më tepër se 6 vjet, në zyra dhe komisione të administratës, pa asnjë të drejtë, duke vazhduar luftën klasore, diskriminimin, padrejtësitë dhe persekutimin që i bëhet, duke i konsideruar si të dënuar politikisht.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri, zgjidhjen e problemit të tij.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ankuesi H.C, ka depozituar pranë Komisionerit, ankesën nr.107 regj., datë 08.06.2021, kundër ish punëdhënësit të tij Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Ankuesi, pretendon se, ka qenë viktimë e diskriminimit, pasi largimi i tij si punonjës pranë kësaj ministrie ndodhur në vitin 2013, ka ndodhur për shkak të bindjeve politike, pasi ankuesi vjen nga një familje e persekutuar për motive politike nga regjimi komunist. Ankuesi pretendon se e drejta që i është cënuar dhe që i është njohur me vendim gjykate të formës së prerë, nuk është rivendosur në vend nga ky subjekt që nga viti 2016, duke bërë që situata e diskriminimit të ndodhur që në vitin 2013 të vazhdojë.

Në kuadër të procedurave të shqyrtimit paraprak dhe pasi u vlerësua se informacioni dhe dokumentacioni nuk ishte i mjaftueshëm, me e-mailin e datës 15.06.2021, ankuesit i'u kërkuar, që brenda datës 18.06.2021 të plotësonte ankesën me informacionin e mëposhtëm:

- Informacion me i detajuar në lidhje me procedurat e ndjekura për ekzekutimin e vendimit, shoqëruar me aktet dhe dokumentacionin përkatës.
- Shpjegime më të hollësishme, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pra të bindjeve politike, dhe lidhjen e këtij shkakut me veprimet diskriminuese që pretendohet se janë kryer nga subjekti kundër të cilit ankuesi ka paraqitur ankesën.

Në përgjigje të kërkesës së mësipërme, ankuesi, me e-mailin e datës 15.06.2021, ndër të tjera ka sqaruar se: *“.....U jam drejtuar ju, ku kërkoj vlerësimin e largimit tim, pasi është thellësisht politik dhe vazhdim i luftës së klasave në forma më të egra çnjerëzore.....”* Me shkresën nr.859/2 prot., datë 18.06.2021, ankuesi ka dërguar informacionin në lidhje me dy çështjet e mësipërme.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, të ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrotjtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) shfuqizuar; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji; c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja; ç) është*

haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese”, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi është paraqitur përtej afateve ligjore të parashikuara nga germa “dh”, e pikës 4, të dispozitës ligjore të sipërcituar, bazuar në arsyetimin vijues:

Së pari, formulimi në nenin 33, pika 4, germa “dh”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon se afati maksimal 3 vjeçar, nga momenti i ndodhjes së diskriminimit dhe afati maksimal 2 vjeçar, nga momenti i marrjes dijani për diskriminimin, nuk janë afate kumulative. Për t’u konsideruar brenda afateve ligjore për shqyrtimin e ankesave nga ana e Komisionerit, ankuesi mund të provojë ose se, nuk kanë kaluar 3 vjet nga ndodhja e diskriminimit, pavarësisht se kur ka marrë dijani, ose në rast se provon se momenti i marrjes dijani është i ndryshëm nga momenti i ndodhjes së diskriminimit, ankuesi është brenda 2 viteve nga marrja dijani.

Së dyti, fakti diskriminues i pretenduar nga ankuesi, sikundër shprehet edhe ai vetë në ankesë, rezulton të ketë ndodhur në datë 12.11.2013, datë në të cilën ankuesi ka kaluar në listë pritje bazuar në shkresën nr.8120 prot., datë 12.11.2013, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit. (aktualisht kjo ministri mban emërtimin Ministria e Turizmit dhe Mjedisit).

Referuar shprehimeve të dhëna nga ankuesi dhe kohën që ai ka identifikuar se kur ka marrë dijani për diskriminimin e pretenduar, rezulton se ankuesi ka marrë dijani për në datën 12.11.2013. Në lidhje me momentin e marrjes dijani, bazuar në aktet e administruara, rezulton e provuar se, ankuesi ka marrë dijani për faktin e pretenduar si diskriminues, pra të kalimit të tij në listë pritje, në datën 12.11.2013, pasi ankuesi e ka kundërshtuar aktin pranë organeve gjyqësore. Pra, rezulton se jemi në kushtet, që momenti kur ka ndodhur diskriminimi i pretenduar është i njëjtë me momentin e marrjes dijani.

Fakti i pretenduar si diskriminues ka ndodhur në datën **12.11.2013**, ankuesi ka marrë dijani për diskriminimit e pretenduar në të njëjtën datë dhe e ka paraqitur ankesën pranë Komisionerit në datën **08.06.2021**, pra në tejkallim të afateve të parashikuara në neni 33, pika 4, germa “dh”, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, germa “dh”, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar dhe për rrjedhojë ankesa nuk mund të pranohet për t’iu nënshtruar procedurave të mëtejshme nga ana e Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “dh” të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 107 Regj., datë 08.06.2021, të paraqitur nga ankuesi H.C kundër Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, pasi është paraqitur tej afateve ligjore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Bindjet politike
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Mospranim